



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE



UNITED NATIONS
ALBANIA



HARTËZIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE NË SHQIPËRI



Leave
No One
Behind

Ky studim është përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror me ekspertizën dhe asistencën teknike të UNDP-së, si pjesë e aktiviteteve të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas" (LNB), mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të UNDP në Shqipëri.

Tiranë, Qershor 2021

Të dhënat e këtij raporti i përkasin periudhës Maj 2021.

Përgatitur nga:

Prof. Asoc. Dr. Arlinda Ymeraj

Nën drejtimin e

Aida Çavo

Zëvendës-Drejtor i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror

Ndihmuan:

Ermelinda Jankishta

Specialiste e shërbimeve shoqërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror

Arkida Hysenaj

Specialiste e shërbimeve shoqërore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror



**Leave
No One
Behind**

United Nations House

Skenderbej Street, Gurten Building, 2nd floor, Tirana, Albania

Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

PËRMBAJTJA

SHKURTESA	4
1. PËRMBLEDHJE	5
2. KUFIZIME TË STUDIMIT	7
3. LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE	8
4. VLERËSIMI I NEVOJËS PËR SHËRBIME SHOQËRORE NË KUADËR TË PROJEKTIT “ASKUSH TË MOS MBETET PAS” (LEAVE NO ONE BEHIND)	11
5. METODOLOGJIA	12
6. ANALIZA E SITUATËS SË SHËRBIMEVE SHOQËRORE	15
6.1. Dimensioni 1 “Vlerësimi i mundësisë për të përdorur shërbime sociale, mbi bazën e Ofertës të shërbimeve” (Oferta e shërbimeve shoqërore)	15
6.2. Dimensioni 2 “Përfituesit e shërbimeve shoqërore sipas qarqeve dhe bashkive” (Kërkesa për shërbime shoqërore)	23
7. ANALIZA E SHËRBIMEVE SIPAS BASHKIVE TË SECILIT QARK	35
7.1. Qarku Berat	35
7.2. Qarku Durrës	41
7.3. Qarku Dibër	45
7.4. Qarku Elbasan	50
7.5. Qarku Fier	57
7.6. Qarku Gjirokastrë	63
7.7. Qarku Kukës	68
7.8. Qarku Korçë	72
7.9. Qarku Lezhë	78
7.10. Qarku Shkodër	83
7.11. Qarku Tiranë	88
7.12. Qarku Vlorë	93
8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	98
SHTOJCAT	99
1. Pyetësi	99
2. Udhëzues për plotësimin e pyetësit	101
3. Numri e institucioneve, shërbimeve dhe përfituesve sipas bashkive dhe qarqeve	103

SHKURTESA

AK	Aftësi të kufizuara
DRSHSH	Drejtoritë Rajonale të Shërbimeve Shoqërore
LNB	Leave no one behind (Askush të mos mbetet pas)
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NE	Ndihma Ekonomike
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UNDP	United Nations Development Program (Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim)

1

PËRMBLEDHJE

Raporti “Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri” udhëhiqet nga kërkesa për të analizuar informacionin ekzistues dhe të dhënat administrative, që pasqyrojnë shërbimet shoqërore në Shqipëri si edhe përfituesit e tyre, me qëllim vlerësimin e nevojës për këto shërbime, për të orientuar procesin e hartimit të politikave efektive të kujdesit shoqëror në nivel qendror e lokal, e më tej, të politikave të përfshirjes shoqërore.

Ky raport është përgatitur duke përdorur të dhënat e mbledhura për herë të parë drejtëpërsëdrejti nga bashkitë, që pasqyrojnë:

- shërbimet shoqërore sipas shpërndarjes së tyre në nivel rajonal e lokal.
- shërbimet shoqërore sipas llojit, mënyrës së financimit, tipologjisë dhe grupeve përfituese.

Të dhënat dhe informacionet u përpunuan në përputhje me një kuadër metodologjik të përgatitur për këtë qëllim, i cili mbështetet në analizën e krahasuar dhe të kryqëzuar të informacionit, për të vlerësuar nevojën për shërbime shoqërore, sipas dy dimensioneve themelore, përkatësisht:

Dimensioni 1: Vlerësimi i mundësisë për të përdorur shërbime sociale, mbi bazën e ofertës së shërbimeve.

Dimensioni 2: Realizimi i së drejtës për përfitim të shërbimeve në përputhje me kërkesën për shërbime.

Analiza e thelluar e informacionit sipas dimensionit të parë, konstatoi se:

- Në Shqipëri ofrohen 493 shërbime sociale nga 339 institucione publike, jo publike dhe të formës së përzier. 46% e shërbimeve sigurohen nga institucione publike, ndërsa 42% e tyre sigurohen nga institucione jo publike. Vetëm 12% e shërbimeve sigurohen nga institucione të formes së përzier (publike dhe jo publike).
- Bashkitë janë financuesit kryesorë të shërbimeve publike me 54% , të pasuara nga format “mikse” të financimit me 24%, Ministria me 19% dhe qarqet me 3%. Sa i përket financimit të shërbimeve jo publike, 55% mbështeten nga OJF-të , 21% nga fondacionet dhe 16% nga organizatat ndërkombëtare dhe 8% nga forma “mikse” (nga më shumë se një burim).
- Numri më i madh i shërbimeve sociale ofrohet në qarkun e Tiranës, ndërsa numri më i vogël ofrohet në qarkun e Kukësit.
- Sipas tipologjisë, 21% e shërbimeve sociale të ofruara, janë “Shërbime komunitare”, 17% janë “Shërbime parashoqërore”, nga 14 % janë shërbime të “Emergjencës” dhe “Rezidenciale”(secila), 11% janë shërbime në familje, ndërsa tipologjitë e tjera të shërbimeve zënë secila një peshë specifike më të ulët se 10%.
- Sipas grupeve të përfituesve, shërbimet sociale të ofruara për familje në nevojë zënë peshën kryesore, rreth 20%, të ndjekura nga shërbimet sociale për fëmijë me AK (17%). Shërbimet për të rinjtë e përjashtuar ose në konflikt me ligjin janë shërbimet që ofrohen më pak.
- Vetëm në qarkun e Tiranës ofrohen të gjitha tipologjitë e shërbimeve dhe marrin shërbime të gjithë grupet e përfituesve. Qarku Dibër ofron numrin më të vogël të tipologjisë së shërbimeve. Në qarqet Durrës, Elbasan dhe Shkodër nuk ofrohen shërbime për të rinj në konflikt me ligjin dhe të rinj nga familje të përjashtuara.

- Në nivel bashkie 5 bashki, përkatësisht bashkitë Rogozhinë, Libohovë, Tepelenë, Himarë dhe Delvinë, nuk ofrojnë asnjë shërbim; 6 bashki, përkatësisht bashkitë Peqin, Selenicë, Pukë, Fushë Arrës, Memaliaj dhe Ura Vajgurore ofrojnë vetëm shërbime për vetëm një grup në nevojë; 31 bashki, përkatësisht bashkitë Kavajë, Kamëz, Vorë, Mat, Dropull, Përmet, Mirditë, Kuçovë, Skrapar, Bulqizë, Klos, Gramsh, Librazhd, Cërrik, Belsh, Tropojë, Devoll, Kolonjë, Maliq, Pustec, Pogradec, Konispol, Finiq, Patos, Roskovec, Lushnje, Divjakë, Mallakastër, Malësi e Madhe, Poliçan, Has, ofrojnë shërbime për 2 deri në 4 grupe në nevojë; 8 bashki, përkatësisht Shijak, Këlcyrë, Kurbin, Berat, Dibër, Prrenjas, Sarandë, Vau Dejës, sigurojnë shërbime për 5 deri në 6 grupe në nevojë, 7 bashki, bashkitë Krujë, Gjirokastrë, Lezhë, Kukës, Korçë, Vlorë dhe Fier, ofrojnë shërbime për 7 deri në 9 grupe në nevojë, bashkitë Durrës, Elbasan dhe Shkodër ofrojnë shërbime për 10 deri në 11 grupe në nevojë, ndërsa vetëm bashkia Tiranë ofron shërbime për të gjitha grupet në nevojë (12) (Tabela 4).
- Sikundër u konstatua në analizën e bashkive sipas numrit të shërbimeve për çdo grup përfitues, edhe në analizën sipas numrit të bashkive që ofrojnë tipologji të ndryshme shërbimesh, konfirmohet se rreth 60% e bashkive ofrojnë deri në tre tipologji shërbimesh, dmth më pak se 40% të tipologjive të përcaktuara në ligj. Vetëm rreth 20% e bashkive ofron mbi 6 tipologji shërbimesh, ndërsa vetëm 3% e bashkive ose 2 bashki, përkatësisht Tirana dhe Elbasani, ofrojnë të gjitha tipologjitë e shërbimeve (Tabela 5).
- Sipas grupeve të përfituesve, 53 bashki nuk kanë shërbime për të rinj të përjashtuar, për viktimat e trafikimit, si edhe të rinjtë në konflikt me ligjin. 49 bashki nuk kanë shërbime për minoritetet etnike Romë dhe Egjiptianë. 47 bashki nuk kanë shërbime për të rritur me AK, 36 bashki nuk kanë shërbime për të moshuar, 32 bashki nuk kanë shërbime për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, ndërsa 18 bashki nuk ofrojnë shërbime për fëmijë me AK, viktimat e dhunës si edhe familje në nevojë.
- Vetëm në 11 bashki ofrohen shërbime për më shumë se 6 grupe në nevojë (nga 12 grupe që analizon ky studim). Shërbimet e ofruara për familjet në nevojë, fëmijët me AK, të moshuarit dhe viktimat e dhunës, zënë peshën kryesore specifike.
- 5 bashki, përkatësisht bashkitë Rogozhinë, Libohovë, Tepelenë, Himarë dhe Delvinë, nuk ofrojnë asnjë shërbim.

Analiza e informacionit në lidhje me vlerësimin e “Kërkesës” për shërbime shoqërore, konstatoi se:

- 53% e përfituesve marrin shërbime sociale në institucione publike, 27% në institucione jo publike dhe 20% në institucione të formës së përzier.
- Qarqet e Tiranës, Shkodrës dhe Dibrës rezultojnë me numrin më të lartë të përfituesve për çdo shërbim. Qarku i Tiranës është i vetmi qark i vendit, në të cilin ofrohen shërbime për të gjitha grupet e përfituesve. Përfituesit e shërbimeve në qarkun e Tiranës zënë peshën më të madhe (35%), ndërsa së bashku me Shkodrën dhe Dibrën, përfaqësojnë rreth 75% të përfituesve të shërbimeve në të gjithë vendin. Fieri është qarku me numrin më të vogël të përfituesve të shërbimeve për 10,000 banorë ndërsa Shkodra është qarku me numrin më të lartë të përfituesve për 10,000 banorë.
- 63% e përfituesve të shërbimeve marrin shërbime të destinuar për familje në nevojë, ndërsa pjesa tjetër e përfituesve janë grupet: fëmijë me AK (9%), të moshuar (5%), viktimat e dhunës në familje (4%), të rritur me aftësi të kufizuar (4%), fëmijë jashtë kujdesit prindëror (3%), viktimat e trafikimit (2%), minoritete etnike (2%), të rinj nga familje të përjashtuara (1%) dhe të rinj në konflikt me ligjin (1%).
- Përfituesit e shërbimeve parashoqërore dominojnë në raport me shërbimet e tjera (63%). 15% e përfituesve marrin shërbime komunitare dhe afërsisht 9% marrin shërbime në familje.
- Në të gjithë vendin, përfitojnë shërbime sociale 42,553 individë.
- Sipas tipologjisë, “këshillimi”, “shërbimet e emergjencës” dhe “të kujdesit alternativ” paraqiten pak të zhvilluara dhe të kufizuara në shpërndarje sipas qarqeve, me një numër të lartë të qarqeve në të cilat këto shërbime nuk ekzistojnë fare. Shërbimet e tjera rezultojnë relativisht të zhvilluara dhe të shpërndara njëtrajtësisht.

2

KUFIZIME TË STUDIMIT

- Vështirësia për të identifikuar saktë llojin e shërbimit si edhe grupin përfitues, për shkak të përkufizimeve të gjera të tipologjive të shërbimeve dhe kapaciteteve të pamjaftueshme të profesionistëve të mbledhjes së të dhënave.
- Mungesa e përdorimit masiv të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit në nivel lokal.
- Mungesa e normave sasiore të matjes dhe raportimit të shërbimeve (numër shërbimesh për individë në nevojë).

3

LISTA E TABELAVE DHE FIGURAVE

- Tabela 1: Shërbimet sociale sipas llojit në çdo qark, numër
- Tabela 2: Shërbimet sociale të institucioneve publike në çdo qark sipas financuesit, numër
- Tabela 3: Shërbimet sociale të institucioneve jo publike në çdo qark, numër
- Tabela 4: Përmbledhje e numrit të shërbimeve sipas grupeve përfituese dhe bashkive
- Tabela 5: Përmbledhje e shërbimeve sociale sipas tipologjisë dhe bashkive
- Tabela 6: Bashkitë që nuk ofrojnë asnjë shërbim ose ofrojnë shërbime për vetëm një grup në nevojë, sipas popullsisë.
- Tabela 7: Përfituesit e shërbimeve sociale sipas llojit dhe qarqeve, numër
- Tabela 8: Përfituesit e shërbimeve sociale publike sipas financuesit dhe qarqeve, numër
- Tabela 9: Përfituesit e shërbimeve sociale jo publike sipas financuesit dhe qarqeve, numër
- Tabela 10: Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim sipas qarqeve
- Tabela 11: Institucione sipas përfituesve dhe shërbime sipas institucioneve në qarqet e vendit, numër.
- Tabela 12: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim në çdo qark sipas grupeve dhe tipologjisë së shërbimeve.
- Tabela 13: Përfituesit e shërbimeve sipas gjinisë dhe grupeve përfituese, në %
- Tabela 14: Shërbimet shoqërore të kategorizuara sipas tipologjisë dhe grupeve përfituese, numër
- Tabela 15: Përfituesit e shërbimeve sipas llojit dhe tipologjisë, numër
- Tabela 16: Përfituesit e shërbimeve sipas tipologjisë dhe grupeve, numër
- Tabela 17: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Berat
- Tabela 18: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Kuçovë
- Tabela 19: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Poliçan
- Tabela 20: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Skrapar
- Tabela 21: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Ura Vajgurore
- Tabela 22: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Durrës
- Tabela 23: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Shijak
- Tabela 24: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Krujë
- Tabela 25: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Dibër
- Tabela 26: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Mat
- Tabela 27: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Bulqizë
- Tabela 28: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Klos
- Tabela 29: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Elbasan
- Tabela 30: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Gramsh
- Tabela 31: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Librazhd
- Tabela 32: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Peqin
- Tabela 33: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Cërrik

- Tabela 34: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Belsh
- Tabela 35: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Prrenjas
- Tabela 36: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Fier
- Tabela 37: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Patos
- Tabela 38: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Roskovec
- Tabela 39: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Lushnje
- Tabela 40: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Divjakë
- Tabela 41: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Mallakastër
- Tabela 42: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Gjirokastrë
- Tabela 43: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Dropull
- Tabela 44: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Përmet
- Tabela 45: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Këlcyrë
- Tabela 46: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Kukës
- Tabela 47: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Tropojë
- Tabela 48: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Has
- Tabela 49: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Korçë
- Tabela 50: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Devoll
- Tabela 51: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Kolonjë
- Tabela 52: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Pogradec
- Tabela 53: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Maliq
- Tabela 54: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Pustec
- Tabela 55: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Lezhë
- Tabela 56: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Kurbin
- Tabela 57: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Mirditë
- Tabela 58: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Shkodër
- Tabela 59: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia M.Madhe
- Tabela 60: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Vau Dejës
- Tabela 61: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Pukë
- Tabela 62: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Tiranë
- Tabela 63: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Kavajë
- Tabela 64: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Kamëz
- Tabela 65: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Vorë
- Tabela 66: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Vlorë
- Tabela 67: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Sarandë
- Tabela 68: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Konispol
- Tabela 69: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Finiq

Figura 1: Shërbimet sociale për çdo qark, numër

Figura 2: Shërbime sociale për 10 mijë banorë sipas qarqeve, numër

Figura 3: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, në %

Figura 4: Shërbime sociale sipas grupeve të përfituesve, në %

Figura 5: Shërbime sociale sipas grupeve përfituese dhe qarqeve, numër

Figura 6: Shpërndarja e shërbimeve sociale sipas tipologjisë dhe qarqeve të vendit

Figura 7: Numri i bashkive që nuk ofrojnë asnjë shërbim sipas grupeve përfituese

Figura 8: Përqindja e përfituesve të shërbimeve në çdo qark

Figura 9: Pësha specifike e përfituesve të shërbimeve për 10,000 banorë sipas qarqeve

Figura 10: Përfituesit sipas grupeve në % ndaj totalit

Figura 11: Përfituesit e shërbimeve sipas tipologjisë në % ndaj totalit

Figura 12: Shpërndarja e përfituesve të shërbimeve sipas qarqeve dhe grupeve, në %.

Figura 13: Shqipëria, Totali i shërbimeve sipas tipologjisë dhe rajoneve

Figura 14: Shqipëria, shërbimet sipas përfituesve, tipologjisë dhe rajoneve

Figura 15, 16, 17 dhe 18: Qarku Berat: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 19, 20, 21 dhe 22: Qarku Durrës: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 23, 24, 25 dhe 26: Qarku Dibër: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 27, 28, 29 dhe 30: Qarku Elbasan: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 31, 32, 33 dhe 34: Qarku Fier: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 35, 36, 37 dhe 38: Qarku Gjirokastrë: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 39, 40, 41 dhe 42: Qarku Kukës: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 43, 44, 45 dhe 46: Qarku Korçë: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 47, 48, 49 dhe 50: Qarku Lezhë: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 51, 52, 53 dhe 54: Qarku Shkodër: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 55, 56, 57 dhe 58: Qarku Tiranë: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

Figura 59, 60, 61 dhe 62: Qarku Vlorë: Shërbimet sipas llojit, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë, Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve, Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarku.

4 Vlerësimi i nevojës për shërbime shoqërore në kuadër të Projektit “Askush të mos mbetet pas” (Leave No One Behind)

Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të një shteti demokratik, funksionimit të ekonomisë së tregut, ruajtjes së një rritjeje të qëndrueshme ekonomike dhe arritjes së zhvillimit njerëzor. Megjithatë, zbatimi i politikave sociale për përfshirjen e grupeve vulnerabël, mbetet problematik. Për të mbështetur përmirësimin e përfshirjes sociale, agjencitë e OKB-së janë angazhuar në zbatimin e projektit «Askush të mos mbetet pas» (LNB), i cili synon që “Personat dhe grupet e përjashtuara apo në rrezik përjashtimi të kenë mundësi të barabarta për të përdorur shërbime shoqërore cilësore, gjë që do të mundësojë pjesëmarrjen në vendimmarrjen publike duke ndikuar në jetën e tyre”. Faza e parë e projektit (2017-2021) është projektuar për të arritur:

- Fuqizimin e popullsisë vulnerabël për të kërkuar dhe përfituar shërbime sociale të përshtatshme dhe cilësore, në nivel vendor, për të mbështetur përfshirjen sociale të tyre.
- Mbështetjen e bashkive për të drejtuar dhe administruar në mënyrë efektive sigurimin e shërbimeve sociale dhe nxitjen e përfshirjes sociale, dhe
- Fuqizuar institucionet kombëtare për të zbatuar kuadrin e tyre të politikave sociale për të siguruar dhe financuar shërbime sociale të qëndrueshme.

Me qëllim rritjen e kapaciteteve të ofruesve publikë dhe jo publikë, në nivel qendror, rajonal dhe lokal, rezulton e nevojshme që nevoja për shërbime shoqërore të vlerësohet edhe në perspektivën afatgjatë me qëllim që SHSSH/MSHMS të udhëheqin politikat dhe veprimet kombëtare dhe lokale në lidhje me shërbimet e kujdesit social.

Në këtë kuadër, UNDP në përputhje me kërkesën e SHSSH, mbështet sigurimin e ekspertizës teknike për të vlerësuar dhe paraqitur shërbimet sociale mbi bazën e një metodologjie të qënësishme të vlerësimit të nevojave, analizës dhe raportimit të tyre, e cila do t’i shërbejë SHSSH-së për të:

- identifikuar mangësitë në ofrimin e këtyre shërbimeve në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar
- udhëhequr bashkitë në procesin e përmirësimit dhe zbatimit të planeve të zhvillimit shoqëror.
- ngritur dhe/ose zgjeruar shërbimet e kujdesit shoqëror për qytetarët në nevojë si edhe nxitjen e përfshirjes së tyre sociale.

5 METODOLOGJIA

Në këtë studim është përdorur metoda sasiore e analizës, e ndërtuar si një kombinim i (a) të dhënave nga burime dytësore statistikore, dhe (b) të dhëna nga vlerësime të tjera të ngjashme.

Kjo metodë konsiston në mbledhjen e të dhënave drejtëpërsëdrejti nga bashkitë (departamentet e shërbimeve sociale) duke përdorur pyetsor të strukturuar (shih Shtojca 1) të shoqëruar edhe nga një shpjegues (shih Shtojca 2).

Metoda e dytë konsiston në mbledhjen e të dhënave nga Planet Sociale të zhvilluara gjatë periudhës 2019-2020 në pjesën më të madhe të bashkive të Shqipërisë, si edhe raporte të tjera të ngjashme me raportin në fjalë, të zhvilluara gjatë tre viteve të fundit, nëpërmjet mbështetjes së UNDP, programi LNB. Procesit të përgatitjes së planeve sociale, të paktën në 30% të bashkive të vendit, i parapriu hartimi i raportit të vlerësimit të nevojave. Këto raporte u përdorën për të ndërtuar të dhënat mbi "Nevojën e përgjithshme për Shërbime Sociale".

Metoda kërkimore, e formëzuar për këtë vlerësim, mbështetet mbi këto cilësi, përkatësisht (i) përshkruese (ii) analitike dhe (iii) shkakësore.

(i) Analiza përshkruese e të dhënave shërben për të prodhuar një listë të detajuar të të gjitha shërbimeve që ofrohen në Shqipëri, sipas shpërndarjes gjeografike, nivelit të qeverisjes (kombëtar, rajonal ose lokal) si edhe llojit të shërbimeve e tipologjisë së tyre, sipas përcaktimeve të ligjit 121/2016 mbi "Shërbimet e Kujdesit Social", neni 8. Kështu:

Shërbimet parashoqërore konsiderohen si shërbime komunitare dhe ofrohen nga strukturat e posaçme të shërbimeve shoqërore në kuptim të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Shërbime rezidenciale janë shërbimet që ofrohen në qendrat rezidenciale dhe, në çdo rast, përfshijnë të paktën shërbime të kujdesit 24-orësh dhe afatgjatë për individë në nevojë.

Shërbime komunitare janë shërbime gjysmëditore ose të plotë ditore, të ofruara në qendra ditore, sipas kategorisë së përfituesve.

Shërbimet në familje janë shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në familje për të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara, të cilët e kanë të pamundur të marrin shërbime ditore komunitare apo rezidenciale.

Shërbime të specializuara janë shërbimet që ofrohen në nivel kombëtar, rajonal apo bashkie nga profesionistë të specializuar në fusha të caktuara.

Shërbim këshillimi është shërbimi i siguar nga profesionistë të fushave të përcaktuara për individë në nevojë.

Shërbimi i emergjencës 72 orë u ofrohet individëve që kanë nevojë për asistencë të menjëhershme për shkak të një situatë që u kërcënon jetën dhe shëndetin, të cilëve u sigurohet minimalisht në mënyrë të menjëhershme akomodimi, ushqimi dhe mjedisi i mbrojtur.

Shërbimi i përkujdesjes alternative siguron zhvillimin, arsimimin, shëndetin dhe mirëqenien e fëmijës dhe i ofrohet fëmijës kur nuk është në interesin më të lartë të tij të qëndrojë në një mjedis familjar të caktuar, sipas përcaktimit të legjislativitetit në fuqi.

Shërbimet gjithashtu përshkruhen edhe sipas mënyrës së financimit.

Klasifikimi i shërbimeve është bërë sipas tipologjisë së tyre, në përputhje me, përkatësisht shërbime:

- Parashoqërore
- Residenciale
- Komunitare
- Të specializuara
- Këshillim
- Emergjencë
- Kujdes alternativ

Gjithashtu në përputhje me nenin 6 të ligjit mbi “Shërbimet Sociale”, përfituesit e shërbimeve sociale për çdo bashki janë analizuar sipas përbërjes dhe gjinisë, përkatësisht sipas kategorive:

- Familje në nevojë
- Fëmijë jashtë kujdesit prindëror
- Fëmijë me Aftësi të Kufizuar
- Të rinj nga familje të përjashtuara
- Të rinj në konflikt me ligjin
- Të rritur me Aftësi të Kufizuar
- Të pastrehë
- Viktima të dhunës në familje
- Viktima të trafikimit
- Minoritete etnike
- Të moshuar në nevojë
- Të tjerë

Në përputhje me nenin 9 të të njëjtit ligj, shërbimet sociale në bazë të mënyrës së financimit klasifikohen në:

- I. Shërbime Publike, përkatësisht nga:
 - Qeveria qendrore*
 - Qarku*
 - Bashkia*
 - Formë e përzier*
- II. Shërbime Jo Publike, përkatësisht nga:
 - Organizata Ndërkombëtare*
 - OJF Lokale*
 - Fondacione*
 - Formë e përzierë*
- III. Shërbime të përziera

ii) Analiza analitike: Të dhënat dhe informacioni i siguruar nga bashkitë nëpërmjet analizës përshkruese është

pasuruar me të dhëna mbi Strukturën Demografike, Popullsinë dhe Varfërinë në secilën bashki të vendit, me qëllim ndërtimin e një pasqyre të plotë të situatës, jo vetëm sipas komponentit të “Ofertës së Shërbimeve”, por edhe sipas komponentit të “Kërkesës për Shërbime”, sipas dy dimensioneve që vijojnë, për të nxjerrë në pah, përkatësisht:

Dimensioni 1: Vlerësimi i mundësisë për të përdorur shërbime sociale, mbi bazën e Ofertës të shërbimeve.

Dimensioni 2: Realizimi i të drejtës për përfitim të shërbimeve në përputhje me Kërkesën për shërbime.

iii) Analiza shkakësore: Harmonizimi i dy analizave të mësipërme, përkatësisht përshkruese dhe analitike, krijon bazën e nevojshme të informacionit për të analizuar dhe vlerësuar në thellësi lidhjen ndërmjet treguesve, për të prodhuar treguesit që vijojnë, të ilustruar me figurat përkatëse, përkatësisht:

- Pësha specifike e shërbimeve sociale sipas llojit, tipologjisë, mënyrës së financimit, grupeve përfituese dhe gjinisë.
- Shpërndarja e krahasuar e shërbimeve sociale sipas qarqeve dhe bashkive, e ndërthurur edhe me analizën sipas llojit, tipologjisë, mënyrës së financimit dhe grupeve përfituese.
- Shpërndarja e krahasuar e shërbimeve sociale për 10 mijë banorë, e klasifikuar edhe sipas kategorive të nënvizuara më lart.
- Vlerësimi i krahasuar i shërbimeve sipas “Numrit mesatar të shërbimeve për çdo qark, bashki, kategori përfituesish, si edhe banorë”.
- Vlerësimi i krahasuar i shërbimeve sipas “Numri mesatar i përfituesve për çdo shërbim, i klasifikuar edhe sipas qarqeve dhe bashkive”.
- Vlerësimi i krahasuar i shërbimeve për çdo qark dhe bashki sipas “Peshës specifike të Përfituesve në raport me Nevojën”.

Analiza e situatës ekzistuese të shërbimeve shoqërore të ofruara në Shqipëri si dhe e grupeve që i përfitojnë

6

ANALIZA E SITUATËS SË SHËRBIMEVE SHOQËRORE

këto shërbime, synon të ofrojë një përshkrim të qartë të situatës, sipas dy dimensioneve:

Dimensioni 1: Vlerësimi i mundësisë për të përdorur shërbime sociale, mbi bazën e Ofertës të shërbimeve.

Dimensioni 2: Realizimi i të drejtës për përfitim të shërbimeve në përputhje me Kërkesën për shërbime.

6.1. DIMENSIONI 1 “Vlerësimi i mundësisë për të përdorur shërbime sociale, mbi bazën e Ofertës të shërbimeve” (Oferta e shërbimeve shoqërore)

Në Shqipëri ofrohen 493 shërbime sociale, publike, jo publike dhe të formës së përzier, të cilat sigurohen nga 339 institucione (shtojca 3), përkatësisht 122 publike dhe 217 jo publike¹. Siç tregon tabela 1, 46% janë shërbime sociale publike, kundrejt 42% që janë shërbime jo publike. Vetëm 12% shërbimeve sociale janë të formës së përzier, publik dhe jo publik.

Tabela 1: Shërbimet sociale sipas llojit në çdo qark, numër

Lloji	Publike	Jo Publike	Përzier	Shuma
Qarku				
Berat	19	3	1	23
Durrës	23	18	4	45
Dibër	5	10	3	18
Elbasan	31	41	0	72
Fier	16	4	3	23
Gjirokastrë	26	10	2	38
Kukës	8	2	2	12
Korçë	17	16	6	39
Lezhë	5	16	7	28
Shkodër	9	15	19	43
Tiranë	44	65	5	114
Vlorë	24	7	7	38
Shuma	227	207	59	493
Në %	46	42	12	100

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabelat 2 dhe 3 sjellin informacion më të detajuar në lidhje me shërbimet e ofruara nga institucione publike dhe jo publike, të cilat paraqiten të kategorizuara edhe sipas financuesit të tyre.

Tabela 2: Shërbimet sociale të institucioneve publike në çdo qark sipas financuesit, numër

¹ SHSSH i disponon të dhënat vetëm të kategorizuara sipas llojit të institucionit si edhe grupit kryesor të përfituesit.

Financuesi	Ministria	Qarku	Bashkia	Përzier	Shuma
Qarku					
Berat	0	1	13	5	19
Durrës	12	0	10	1	23
Dibër	0	0	2	3	5
Elbasan	0	5	15	11	31
Fier	3	0	7	6	16
Gjirokastrë	5	0	12	9	26
Kukës	0	0	2	6	8
Korçë	3	0	10	4	17
Lezhë	0	0	2	3	5
Shkodër	1	0	6	2	9
Tiranë	16	2	24	2	44
Vlorë	2	0	20	2	24
Shuma	42	8	123	54	227
Në %	19	3	54	24	100

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Sipas të dhënave të tabelës 2, bashkitë janë financuesit kryesorë të shërbimeve të institucioneve publike, 54%, të pasuara nga format "mikse" të financimit të shërbimeve, përkatësisht 24%. Ministria (niveli qendror i administrimit) financon 19% të shërbimeve të institucioneve publike.

Tabela 3: Shërbimet sociale të institucioneve jo publike në çdo qark, numër


Financuesi	Org. Nd.	OJF	Fondacion	Përzier	Shuma
Qarku					
Berat	1	0	2	0	3
Durrës	3	6	3	6	18
Dibër	1	3	3	3	10
Elbasan	3	26	12	0	41
Fier	0	1	1	2	4
Gjirokastrë	3	0	6	1	10
Kukës	2	0	0	0	2
Korçë	0	2	13	1	16
Lezhë	11	0	2	3	16
Shkodër	3	11	1	0	15
Tiranë	7	58	0	0	65
Vlorë	0	6	1	0	7
Shuma	34	113	44	16	207
Në %	16	55	21	8	100

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 3 dëshmon se OJF janë financuesit kryesorë të shërbimeve jo publike (55%), të ndjekura nga "fondacionet", që financojnë 21% të shërbimeve si edhe Organizatat Ndërkombëtare që financojnë 16% të shërbimeve sociale. Vetëm 8% e shërbimeve financonet me mënyra "mikse", nga më shumë se një burim.

Sa i përket shpërndarjes gjeografike, numri më i madh i shërbimeve sociale ofrohet në qarkun e Tiranës, (Figura 1, 114 shërbime). Në qarkun e Kukësit ofrohet numri më i vogël i shërbimeve, gjithsej 12.


Figura 1: Shërbimet sociale për çdo qark, numër



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Megjithatë, vetëm paraqitja e numrit të shërbimeve sipas qarqeve nuk ndihmon në krijimin e perceptimit të plotë të shpërndarjes së shërbimeve në raport me popullsinë. Për rrjedhojë, të dhënat mbi numrin e shërbimeve për çdo qark janë paraqitur në korrelacion me popullsinë e qarqeve, sipas treguesit të "shërbimeve sociale për 10 000 banorë"², siç paraqitet në figurën 2. Për të plotësuar kuadrin e analizës, është llogaritur gjithashtu edhe numri mesatar i shërbimeve për 10 000 banorë, në rang vendi.

Figura 2: Shërbime sociale për 10 mijë banorë sipas qarqeve, numër



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021


Siç gjykohet nga të dhënat e figurës 2, vetëm qarqet Gjirokastrë, Elbasan, Vlorë, Lezhë dhe Shkodër ofrojnë

² Për shkak të mungesës së standardeve të vlerësimit sasior të shërbimeve, të nevojshme për të gjykuar mbi aksesin e qytetarëve në nevojë për shërbime, është përdorur treguesi i popullsisë. Por, me qëllim krahasimin e të dhënave ndërmjet qarqeve dhe bashkive, të dhënat janë llogaritur për 10,000 banorë (emërues i përbashkët).

shërbime më shumë se sa niveli mesatar. Në qarqet e tjera, përfshirë edhe Tiranën dhe Durrësin, numri i shërbimeve për 10,000 banorë, është më i ulët se sa niveli mesatar, ndërsa në qarkun e Fierit, ky numër është edhe më pak se sa 1 shërbim për 10,000 banorë.

Figura 3 paraqet shërbimet sociale të ofruara sipas tipologjisë. Siç edhe konstatohet lehtësisht, rreth 1/5 e shërbimeve të ofruara janë shërbime komunitare (21%), të ndjekura nga shërbimet parashoqërore (17%), ato të emergjencës dhe residenciale, secila nga 14%, shërbimet në familje rreth 11%, ndërsa format e tjera të shërbimeve zënë një peshë specifike më të ulët, nën 10%.

Figura 3: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, në %




Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Të dhënat e figurës 3, dëshmojnë larmishmërinë e shërbimeve të ofruara, në tipologji dhe në numër.

Për të plotësuar kuadrin e analizës së shërbimeve sociale të ofruara, në figurën 4 paraqiten shërbimet sociale sipas grupeve të përfituesve, në përqindje. Shërbimet shoqërore në këtë studim janë analizuar për 11 kategori specifike përfituesish si edhe për “të tjerë”, pra gjithsej 12 kategori, siç paraqiten në figurën 4. Shërbimet sociale të ofruara për familje në nevojë³ zënë peshën kryesore, rreth 20%, të ndjekura nga shërbimet sociale për fëmijë me AK. Shërbimet për të rinjtë e përjashtuar ose në konflikt me ligjin, janë shërbimet që ofrohen më pak.


Figura 4: Shërbime sociale sipas grupeve të përfituesve, në %

³ Familje, të ardhurat e të cilave janë pranë kufirit të varfërisë ose nën kufirin e varfërisë.



Megjithatë jo të gjitha shërbimet sociale ofrohen në çdo qark të Shqipërisë. Figura 5 dëshmon se vetëm në qarkun e Tiranës ofrohen të gjitha shërbimet. Në Durrës, Elbasan dhe Shkodër nuk ofrohen shërbime për të rinj të familjeve të përjashtuara si edhe të rinj në konflikt me ligjin. Në qarkun e Kukësit, qarku me numrin më të vogël të shërbimeve, ofrohen shërbime vetëm për gjysmën e kategorive në krahasim me Tiranën përkatësisht vetëm për “Familje në nevojë”, “Fëmijë me AK”, “Fëmijë jashtë kujdesit prindëror”, “Viktima të dhunës në familje”, “Viktima të trafikut” dhe “Të moshuar”.

Figura 5: Shërbime sociale sipas grupeve përfituese dhe qarqeve, numër



Analiza sipas qarqeve, sado e rëndësishme që të jetë, nuk lejon evidentimin e shpërndarjes së shërbimeve

shoqërore tek qytetari, në komunitetin e tij. Për këtë qëllim, shpërndarja e shërbimeve shoqërore sipas grupeve të përfituesve është analizuar edhe sipas bashkive, e para, për të kuptuar më qartë se cila është mundësia efektivisht reale e qytetarëve për të aksesuar shërbimet shoqërore, dhe e dyta, sepse bashkitë janë ligjërisht përgjegjëse për sigurimin e shërbimeve shoqërore.

Analiza e shpërndarjes së shërbimeve shoqërore sipas grupeve të përfituesve në nivel bashkie (tabela 4) është realizuar duke grupuar bashkitë sipas numrit të grupeve të përfituesve për të cilët ato ofrojnë shërbime, përkatësisht nga bashki që nuk ofrojnë asnjë shërbim, në bashki që i ofrojnë të gjitha shërbimet. Grupet e përfituesve janë konsideruar ato grupe që përcakton ligji, të sqaruara dhe tek metodologjia e këtij raporti.

Tabela 4: Përmbledhje e numrit të grupeve përfituese sipas bashkive


Bashki që ofrojnë shërbime për:	Numri bashkive	Bashkitë
Asnjë grup në nevojë/asnjë shërbim	5	Rrogozhinë, Libohovë, Tepelenë, Himarë, Delvinë
Një grup në nevojë	6	Peqin, Selenicë, Pukë, Fushë Arrës, Memaliaj, Ura Vajgurore
Dy grupe në nevojë	15	Vorë, Dropull, Mirditë, Kuçovë, Skrapar, Bulqizë, Klos, Cërrik, Tropojë, Has, Gramsh, Finiq, Patos, Divjakë, Mallakastër
Tre grupe në nevojë	9	Kavajë, Mat, Belsh, Maliq, Pustec, Malësi e Madhe, Konsipol, Lushnje, Poliçan
Katër grupe në nevojë	7	Kamëz, Përmet, Librazhd, Kolonjë, Devoll, Pogradec, Roskovec
Pesë grupe në nevojë	6	Këlcyrë, Berat, Dibër, Prrenjas, Sarandë, Vau Dejës
Gjashtë grupe në nevojë	2	Shijak, Kurbin
Shtatë grupe në nevojë	2	Krujë, Kukës
Tetë grupe në nevojë	4	Lezhë, Korçë, Vlorë, Fier
Nëntë grupe në nevojë	1	Gjirokastrë
Njëmbëdhjetë grupe në nevojë	3	Durrës, Elbasan, Shkodër
Të gjitha grupet	1	Tiranë
Bashki gjithsej	61	

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 4 tregon se 41 bashki (60% e bashkive) ofrojnë shërbime për një deri në katër (30%) grupe në nevojë. Rreth 25% e bashkive ofron shërbime për 50 deri 75% të grupeve në nevojë, ndërsa vetëm 7% e bashkive (4 bashki, përkatësisht Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Tiranë) ofrojnë shërbime për mbi 80% të grupeve në nevojë.

Figura 6 ilustron shpërndarjen e shërbimeve sociale sipas tipologjisë dhe qarqeve të vendit.

Figura 6: Shërbimet sociale sipas tipologjisë dhe qarqeve, numër



Pavarësisht konstatimit se thajse të gjitha tipologjitë e shërbimeve ofrohen në çdo qark të vendit, analiza sipas bashkive dëshmon se ky përfundim nuk vlen për çdo bashki.

Tabela 5: Përmbledhje e shërbimeve sociale sipas tipologjisë dhe bashkive

Treguesi	Numri	Bashkitë	Në %
Bashki që nuk ofrojnë asnjë shërbim shoqëror/asnjë tipologji	5	Rrogozhinë, Libohovë, Tepelenë, Himarë, Delvinë	9
Bashki që ofrojnë vetëm një tip shërbimi	7	Peqin, Selenicë, Pukë, Fushë Arrës, Memaliaj, Divjakë, Ura Vajgurore	11
Bashki që ofrojnë dy tipe shërbimi	12	Dropull, Mirditë, Skrapar, Bulqizë, Gramsh, Cërrik, Tropojë, Has, Finiq, Patos, Lushnje, Mallakastër	20
Bashki që ofrojnë tre tipe shërbimi	12	Këlcyrë, Dibër, Sarandë, Vau Dejës, Përmet, Poliçan, Pustec, Librazhd, Belsh, Konsipol, Roskovec, Malësi e Madhe	20
Bashki që ofrojnë katër tipe shërbimi	8	Kavajë, Krujë, Devoll, Shijak, Kamëz, Klos, Mat, Maliq	13
Bashki që ofrojnë pesë tipe shërbimi	5	Kuçovë, Prrenjas, Kukës, Kolonjë, Pogradec	8
Bashki që ofrojnë 6 tipe shërbimi	7	Vorë, Durrës, Kurbin, Berat, Korçë, Vlorë, Shkodër	11
Bashki që ofrojnë 7 tipe shërbimi	3	Gjirokastër, Lezhë, Fier	5
Bashki që ofrojnë të gjitha tipet e shërbimeve	2	Tiranë, Elbasan	3
Shuma	61		100

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Sikundër u kontaktua në analizën e bashkive sipas numrit të shërbimeve për çdo grup përfitues, edhe në analizën sipas numrit të bashkive që ofrojnë tipologji të ndryshme shërbimesh, konfirmohet se rreth 60% e bashkive ofrojnë deri në tre tipologji shërbimesh, dmth më pak se 40% të tipologjive të përcaktuara në ligj. Vetëm rreth 20% e bashkive ofron mbi 6 tipologji shërbimesh, ndërsa vetëm 3% e bashkive ose 2 bashki , përkatësisht Tirana dhe Elbasani, ofrojnë të gjitha tipologjitë e shërbimeve.

Për të plotësuar kuadrin e analizës mbi mundësinë e qytetarëve për të përdorur shërbime shoqërore, le të

analizojmë të dhënat e tabelës 6, e cila paraqet “Bashkitë që nuk ofrojnë asnjë shërbim ose ofrojnë vetëm 1 shërbim sipas grupeve dhe tipologjisë në raport me popullsinë e tyre”. Në këtë tabelë, bashkitë janë grupuar sipas “Popullsisë”, përkatësisht:

- Bashki me popullsi deri 10,000 banorë.
- Bashki me popullsi 10,001 deri 20,000 banorë,
- Bashki me popullsi 20,001 deri 30,000 banorë.

Tabela 6: Bashkitë që nuk ofrojnë asnjë shërbim ose ofrojnë vetëm një tipologji shërbimi, sipas popullsisë


Bashkitë sipas popullsisë	Numri i Bashkive	Bashkitë
Deri 5,000 banorë	1	Libohovë
5,001 deri 10,000 banorë	4	Tepelenë, Himarë, Delvinë, Fushë Arrës
10,001 deri 20,000 banorë	3	Selenicë, Pukë, Memaliaj
20,001 deri 30,000 banorë	3	Rrogozhinë, Ura Vajgurore, Peqin
Bashki Gjithsej	11	Në %: 18%

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Analiza e thelluar edhe sipas kriterit të “Shërbimeve sipas grupeve përfituese” tregon se në 54 bashki ose thuhetse në 90% e të gjitha bashkive të vendit, mungojnë shërbimet për të rinj të përjashtuar, për viktimat e trafikimit si edhe të rinjtë në konflikt me ligjin.

49 bashki ose 80% e të gjitha bashkive të vendit nuk kanë shërbime për minoritetet etnike⁴, Romë dhe Egjyptianë. 47 bashki ose 77% e bashkive të vendit nuk kanë shërbime për të rritur me AK, 36 bashki ose thuhetse 60% e bashkive të vendit nuk kanë shërbime për të moshuar. 32 bashki ose mëse 50% e bashkive të vendit nuk kanë shërbime për fëmijë jashtë kujdesit prindëror, ndërsa rreth 30% e bashkive të vendit nuk ofrojnë shërbime për fëmijë me AK.

Figura 7: Numri i bashkive që nuk ofrojnë asnjë shërbim sipas grupeve përfituese.



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

⁴ Ndonëse minoriteti Rom dhe Egjyptian nuk identifikohet në çdo bashki, për pamundësi përjashtimi të bashkive në të cilat ky komunitet jeton, analiza është bërë në raport me numrin e përgjithshëm të bashkive. Gjithashtu, kjo e dhënë ka vetëm efekt ilustrativ. Lista e saktë e shërbimeve që ofrohen në çdo bashki pasqyrohet tek shtojca 3.

Figurat 47 deri 50 ilustrjnë situatën e shërbimeve sociale në bashkitë e qarkut Lezhë. Siç konstatohet nga figura 47, shërbimet publike dominojnë në Kurbin dhe Mirditë (50%), ndërsa në Lezhë përbëjnë vetëm 10%. Shërbimet jo publike përbëjnë 70% të shërbimeve në Lezhë, 50% të tyre në Mirditë si edhe 20% të shërbimeve në Kurbin. 30% të shërbimeve në Kurbin dhe 20% në Lezhë e përbëjnë gjithashtu shërbimet e përziera.

Figura 47: Shërbimet sipas llojit dhe financimit




Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 48 ilustron jo vetëm numrin mesatar të përfituesve sipas tipologjisë së shërbimeve, por edhe peshën specifike të secilës tipologji shërbimi në secilën bashki. Në bashkitë Lezhë sigurohen 7 tipologji shërbimesh. Në Kurbin ofrohen 6 tipologji shërbimesh dhe në Bashkinë Mirditë ofrohen 3 tipologji shërbimesh.

Ndër këto shërbime, numri më i lartë i përfituesve mesatar për çdo shërbim i takon shërbimeve parashoqërore në Kurbin (103 përfitues/shërbim). Treguesit e tjerë lëkundën brenda kufijve të pranueshmërisë, ndonëse për shërbimet e këshillimit dhe emergjencës në bashkinë Kurbin si edhe shërbimet residenciale dhe të emergjencës në Lezhë, numri mesatar i përfituesve është i ulët.


Figura 48: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 49 ilustron numrin mesatar të përfituesve për çdo shërbim sipas grupit të përfituesve si edhe sipas bashkive. Siç konstatohet, në Bashkinë Lezhë përfitojnë shërbime 6 grupe, që janë "Familje në nevojë", "Fëmijë jashtë kujdesit prindëror", "Fëmijë me AK", "Romë" dhe "të Moshuar", përkatësisht 35,3,18,88 dhe 50 përfitues mesatarisht për shërbim. Në bashkinë Kurbin përfitojnë shërbime 5 grupe, që janë "Familje në nevojë", "Fëmijë jashtë kujdesit prindëror", "Fëmijë me AK", "Viktima të dhunës" dhe "Të rinj në konflikt me ligjin", përkatësisht 103,7,1017,20 dhe 3 përfitues/shërbim. Në bashkinë Mirditë përfitojnë vetëm viktima të dhunës, por për shkak të numrit tejet të ulët nuk pasqyrohet.


Figura 49: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 50 ilustron mënyrën e ndarjes të përfitimeve sociale, ndërmjet pagesave monetare për individë të familjeve të varfëra (NE), pagesën e aftësisë së kufizuar si edhe përfituesit e shërbimeve. Qartësisht vërehet se përfituesit e shërbimeve zënë peshë specifike mjaft të vogël në totalin e përfituesve të përkrahjes dhe mbrojtjes sociale.

Figura 50: Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarkut



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

7.10 QARKU SHKODËR

Tipologjitë e shërbimeve sociale në bashkitë e qarkut janë të larmishme tek Bashkia Shkodër dhe të kufizuara tek bashkitë e tjera. Në bashkinë Shkodër ofrohen 6 nga 8 tipologji (nuk ofrohet vetëm “Këshillim” dhe “Shërbime në familje”), tek Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe ofrohen 3 nga 8 tipologji (Vau i Dejës: Residenciale, Komunitare, Këshillim; Malësi e Madhe: Emergjencë, Kujdes Alternativ, Shërbime në familje), ndërsa në Pukë ofrohet 1 tipologji shërbimi dhe në Fushë Arrëz nuk ofrohet asnjë shërbim.

Tabelat 58,59, 60 dhe 61 përshkruajnë në mënyrë të detajuar shërbimet sipas tipologjive dhe grupeve përfituese, përfituesit gjithsej sipas secilit grup dhe gjinisë, në secilën bashki të qarkut.

“Viktimat e dhunës në familje” është grupi më i trajtuar sepse shërbime për “Viktimat e dhunës” sigurohen nga të gjitha bashkitë e qarkut. Shërbimet për “Familjet në nevojë” dhe “Fëmijë me AK” sigurohen nga Bashkitë Shkodër dhe Malësi e Madhe; Shërbimet për “të Rritur me AK” dhe të “Moshuar” sigurohen bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës.

Tabela 58: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Shkodër

Kategoritë e përfituesve të shërbimesve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë	1	2	1						4	9,437	0
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror		3	1					1	5	62	0
Fëmijë AK		1	3		1				5	262	0
Të rinj të përjashtuar			1						1	0	0
Të rinj konflikt me ligjin			2						2	0	0
Të rritur AK		2	1						3	162	0
Të pastrehë			1						1	0	0
Viktima të dhunës	1	2	1				1		5	287	0
Viktima Trafikimit		2							2	4	0
Minoritete Etnike			1						1	0	0
Të moshuar		2	1						3	105	0
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	2	14	13	0	1	0	1	1	32	10,319	0

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 59: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Malësi e Madhe

Kategoritë e përfituesve të shërbimesve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë				1					1	891	0
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror									0	0	0
Fëmijë AK				1			1		2	60	14
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	0	0
Të rritur AK									0	0	0
Të pastrehë									0	0	0
Viktima të dhunës								1	1	2	2
Viktima Trafikimit									0	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar									0	0	0
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	0	0	0	2	0	0	1	1	4	953	16

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 60: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Vau Dejës

Kategoritë e përfituesve të shërbimesve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë									0	0	0
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror						1			1	0	0
Fëmijë AK									0	0	0
Të rinj të përjashtuar									0	1	0
Të rinj konflikt me ligjin		1							1	0	0
Të rritur AK		1							1	32	0
Të pastrehë									0	0	0
Viktima të dhunës			1						1	11	11
Viktima Trafikimit									0	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar		1							1	22	9
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	0	3	1	0	0	1	0	0	5	66	20

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021


Tabela 61: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Pukë

Kategoritë e përfituesve të shërbimeve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë									0	0	0
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror									0	0	0
Fëmijë AK									0	0	0
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	0	0
Të rritur AK									0	0	0
Të pastrehë									0	0	0
Viktima të dhunës							1		1	4	4
Viktima Trafikimit									0	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar									0	0	0
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	0	0	0	0	0	0	1	0	1	4	4

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figurat 51 deri 54 ilustrojnë situatën e shërbimeve sociale në bashkitë e qarkut Shkodër. Siç konstatohet nga figura 55, shërbimet publike dominojnë plotësisht në Pukë dhe Malësi e madhe, ndërsa ato jo publike në Vau I Dejës (80%). Bashkia Vau I Dejës gjithashtu ofron edhe shërbime publike, ndonëse ato përbëjnë vetëm 20% të totalit të shërbimeve. Bashkia Fushë Arrëz ofron vetëm shërbime të financuara nga burime publike dhe jo publike, ndërsa bashkia Shkodër ofron shërbime publike(10%), Jo Publike (30%) dhe të Përziera (60%).

Figura 51: Shërbimet sipas llojit dhe financimit




Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 52 ilustron jo vetëm numrin mesatar të përfituesve sipas tipologjisë së shërbimeve, por edhe peshën specifike të secilës tipologji shërbimi në secilën bashki.

Numri më i lartë i përfituesve mesatar për çdo shërbim i takon shërbimeve parashoqërore në Shkodër (4,695 përfitues/shërbim) dhe shërbimeve në "Familje" në Malësinë e Madhe (461 përfitues/shërbim). Treguesit e tjerë lëkundën brenda kufijve të pranueshmërisë, por në bashkitë e Pukës dhe Malësisë së Madhe (kujdesi alternativ), numri mesatar i përfituesve për një shërbim është tejet i ulët.


Figura 52: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 53 ilustron numrin mesatar të përfituesve për çdo shërbim sipas grupit të përfituesve si edhe sipas bashkive. Siç konstatohet, në Bashkinë Shkodër përfitojnë shërbime 7 grupe, përkatësisht "Familje në nevojë", "Fëmijë jashtë kujdesit prindëror", "Fëmijë me AK", "Të rritur me AK", "Viktima të dhunës në familje", "Viktima të trafikimit" dhe "Të Moshuar", përkatësisht 2359,12,52,54,57,2 dhe 35 përfitues mesatarisht për shërbim. Në bashkitë Malësi e madhe dhe Vau i dejës përfitojnë shërbime 3 grupe, përkatësisht "Familje në nevojë", "Fëmijë me AK" dhe "Viktima të dhunës" në bashkinë M.Madhe (891,30 dhe 2 përfitues/shërbim), ndërsa "Të rritur me AK", "Viktima të dhunës" dhe "Të moshuar", përkatësisht 32,11 dhe 22 përfitues/shërbim në bashkinë e Vaut të Dejës. Në dy bashkitë e tjera përfitojnë shërbime nga një grup, "Viktimat e dhunës", përkatësisht 4 dhe 7 përfitues/shërbim në secilën bashki.


Figura 53: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 54 ilustron mënyrën e ndarjes të përfitimeve sociale, ndërmjet pagesave monetare për individë të familjeve të varfëra (NE), pagesën e aftësisë së kufizuar si edhe përfituesit e shërbimeve. Qartësisht vërehet se përfituesit e shërbimeve zënë peshë specifike mjaft të vogël në totalin e përfituesve të përkrahjes dhe mbrojtjes sociale.

Figura 54: Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarkut



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

7.11. QARKU TIRANË

Në bashkitë e qarkut Tiranë, ofrohen shërbime të larmishme, me përjashtim të bashkisë Rrogozhinë, në të cilën nuk ofrohet asnjë shërbim.

Tipologjitë e shërbimeve sociale në bashkitë e qarkut Tiranë janë gjithashtu të larmishme. Në bashkinë Tiranë, bashkinë më të madhe të vendit sigurohen shërbime të të gjitha tipologjive për 9,983 përfitues gjithsej, mesatarisht 119 përfitues/shërbim për të gjitha shërbimet për të gjithë bashkinë. Bashkia Vorë siguron shërbime të 6 tipologjive, ndërsa bashkitë Kamëz dhe Kavajë ofrojnë 4 tipologji shërbimesh.

Në Bashkinë Tiranë përfitojnë shërbime të gjitha grupet e përfituesve.

Tabelat 62, 63, 64 dhe 65 përshkruajnë në mënyrë të detajuar shërbimet sipas tipologjive dhe grupeve përfituese, përfituesit gjithsej sipas secilit grup dhe gjinisë, në secilën bashki të qarkut.

Tabela 62: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Tiranë

Kategoritë e përfituesve të shërbimesve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë	7								7	4,650	2,120
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror		4							4	614	218
Fëmijë AK	2	2	4	1	3			3	15	322	158
Të rinj të përjashtuar	3		1	2					6	335	199
Të rinj konflikt me ligjin			2	1		1			4	162	15
Të rritur AK	3	1			1				5	312	167
Të pastrehë					2		1		3	1,343	268
Viktima të dhunës					4	2	2		8	212	111
Viktima Trafikimit		1			2	1	1		5	358	358
Minoritete Etnike			2	1	1	1	5		10	423	199
Të moshuar	1	5	2	2			5		15	684	269
Të tjerë				1		1			2	568	290
Gjithsej	16	13	11	8	13	6	14	3	84	9,983	4,372

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 63: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Kavajë

Kategoritë e përfituesve të shërbimesve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë									0	0	0
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror									0	0	0
Fëmijë AK			1		1				2	90	46
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	0	0
Të rritur AK									0	0	0
Të pastrehë	1								1	259	112
Viktima të dhunës									0	0	0
Viktima Trafikimit									0	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar		1			1				2	58	28
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	1	1	1	0	2	0	0	0	5	407	186

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 64: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Kamëz

Kategoritë e përfituesve të shërbimesve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë	1								1	3,821	75
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror									0	6	3
Fëmijë AK			1						1	40	34
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	6	0
Të rritur AK									0	0	0
Të pastrehë									0	0	0
Viktima të dhunës	1	1	1			1			4	135	127
Viktima Trafikimit									0	2	2
Minoritete Etnike									0	70	30
Të moshuar			1						1	110	91
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	2	1	3	0	0	1	0	0	7	4,190	362


Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 65: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Vorë

Kategoritë e përfituesve të shërbimeve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë		3		2		2	4	1	12	168	109
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror			1	1			1	1	4	23	14
Fëmijë AK									0	0	0
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	0	0
Të rritur AK									0	0	0
Të pastrehë									0	0	0
Viktima të dhunës			1				1		2	22	22
Viktima Trafikimit									0	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar									0	0	0
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	0	3	2	3	0	2	6	2	18	213	145

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figurat 55 deri 58 ilustrjnë situatën e shërbimeve sociale në bashkitë e qarkut Tiranë. Siç konstatohet nga figura 55, në bashkinë Tiranë ofrohen të tre llojet e shërbimeve, përkatësisht publike (40%), jo publike (50%) dhe të përziera (10%). Në bashkitë Kamëz dhe Vorë ofrohen vetëm 2 lloje shërbimesh, përkatësisht publike (40% dhe 10%) dhe Jo publike (60% dhe 90%). Në bashkinë Kavajë ofrohen vetëm shërbime publike, ndërsa në bashkinë Rrogzhinë nuk ofrohet asnjë shërbim.


Figura 55: Shërbimet sipas llojit dhe financimit

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 56 ilustron jo vetëm numrin mesatar të përfituesve sipas tipologjisë së shërbimeve, por edhe peshën specifike të secilës tipologji shërbimi në secilën bashki. Në bashkinë Tiranë, bashkinë më të madhe të vendit sigurohen shërbime të të gjitha tipologjive, gjithsej 84 shërbime të 8 tipologjive për 9,983 përfitues. Shërbimet parashoqërore përbëjnë 19%, të emergjencës 17%, residencialet dhe shërbimet e specializuara nga 15%, shërbimet komunitare 13%, shërbimet në familje 10%, këshillimi 7% dhe kujdesi alternativ 4%. Sa i përket numrit mesatar të përfituesve për çdo shërbim, ai është përkatësisht 141(parashoqërore),409 (residenciale), 127 (komunitare),145 (familje), 65 (të specializuara), 417 (këshillim),79 (emergjencë) dhe 70 (kujdes alternativ), mesatarisht 119 përfitues për të gjitha shërbimet për të gjithë bashkinë.

Bashkia Kamëz dhe Kavajë ofrojnë 4 tipologji shërbimesh. Në Kamëz, shërbimet parashoqërore përbëjnë 90%, "Residencialet, 3%; Shërbimet komunitare, 3% dhe "Këshillimi", 4%, duke siguruar shërbime për 1,924; 17;52 dhe 170 përfitues/shërbim. Bashkia Kavajë ofron shërbime parashoqërore (80%), Residenciale (15%), Komunitare (3%)dhe të "Specializuara"(2%), nga të cilat përfitojnë 315,58,22 dhe 12 përfitues për shërbim.


Figura 56: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 57 ilustron numrin mesatar të përfituesve për çdo shërbim sipas grupit të përfituesve si edhe sipas bashkive. Siç konstatohet, në Bashkinë Tiranë përfitojnë shërbime të gjitha grupet e përfituesve, përkatësisht 66 4,154,21,56,41,62,448,27,72,42 dhe 46 përfitues/shërbim sipas listës të paraqitur në figurë. Bashkia Kamëz ofron shërbime për 4 grupe, për "Familje në nevojë" (3,821), "Fëmijë me AK" (40), "Viktima të dhunës në familje"(34) dhe "Të moshuar" (110) përfitues/shërbim. Bashkia Kavajë dhe Vorë ofron shërbime secila për nga 3 grupe. Bashkia Kavajë ofron shërbime për "fëmijë me AK", të "pa strehë" dhe "të moshuar", përkatësisht 45,259 dhe 29 përfitues për shërbim. Bashkia Vorë siguron shërbime për "Familje në nevojë", "Fëmijë jashtë kujdesit prindëror" dhe "Viktima të dhunës në familje", përkatësisht për 14,6 dhe 11 përfitues/shërbim.


Figura 57: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 58 ilustron mënyrën e ndarjes të përfitimeve sociale, ndërmjet pagesave monetare për individë të familjeve të varfëra (NE), pagesën e aftësisë së kufizuar si edhe përfituesit e shërbimeve. Qartësisht vërehet se përfituesit e shërbimeve zënë peshë specifike mjaft të vogël në totalin e përfituesve të përkrahjes dhe mbrojtjes sociale.

Figura 58: Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarkut



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

7.12. QARKU VLORË

Tabelat 66, 67, 68 dhe 69 përshkruajnë në mënyrë të detajuar shërbimet sipas tipologjive dhe grupeve përfituese, përfituesit gjithsej sipas secilit grup dhe gjinisë, në secilën bashki të qarkut.

Tabela 66: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Vlorë

Kategoritë e përfituesve të shërbimeve	Shërbime sipas tipologjisë								Përfitues shërbimesh		
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë	3		1			1			5	0	0
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror	2	1	1				1		5	56	25
Fëmijë AK	1	1			1		1		4	0	0
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	0	0
Të rritur AK	1		1		1				3	0	0
Të pastrehë					1				1	0	0
Viktima të dhunës	1	1	1			1	1		5	151	128
Viktima Trafikimit		1				1			2	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar									0	0	0
Të tjerë	1		1						2	0	0
Gjithsej	9	4	5	0	3	3	3	0	27	207	153

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 67: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Sarandë

Kategoritë e përfituesve të shërbimesve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë			1						1	10	4
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror		1							1	30	15
Fëmijë AK			1						1	31	13
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	0	0
Të rritur AK									0	0	0
Të pastrehë									0	0	0
Viktima të dhunës							1		1	0	0
Viktima Trafikimit									0	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar			1						1	45	10
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	0	1	3	0	0	0	1	0	5	116	42

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Tabela 68: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Konispol

Kategoritë e përfituesve të shërbimesve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë				1					1	146	62
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror								1	1	1	0
Fëmijë AK									0	12	0
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	0	0
Të rritur AK									0	336	46
Të pastrehë									0	0	0
Viktima të dhunës							1		1	0	0
Viktima Trafikimit									0	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar									0	0	0
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	0	0	0	1	0	0	1	1	3	495	108

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021


Tabela 69: Shërbimet sociale sipas tipologjisë, grupeve përfituese si edhe përfituesit, numër, Bashkia Finiq

Kategoritë e përfituesve të shërbimeve	Shërbime sipas tipologjisë									Përfitues shërbimesh	
	Parashoqërore	Residenciale	Komunitare	Familje	Specializuara	Këshillim	Emergjencë	Kujdes Alternativ	Gjithsej	Gjithsej	Femra
Familje në nevojë									0	0	0
Fëmijë jashtë kujdesit prindëror									0	0	0
Fëmijë AK									0	0	0
Të rinj të përjashtuar									0	0	0
Të rinj konflikt me ligjin									0	0	0
Të rritur AK				1					1	4	4
Të pastrehë									0	0	0
Viktima të dhunës							1		1	6	5
Viktima Trafikimit									0	0	0
Minoritete Etnike									0	0	0
Të moshuar									0	0	0
Të tjerë									0	0	0
Gjithsej	0	0	0	1	0	0	1	0	2	10	9

Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figurat 59 deri 62 ilustrojnë situatën e shërbimeve sociale në bashkitë e qarkut Vlorë. Siç konstatohet nga figura 59, shërbimet publike dominojnë plotësisht në Sarandë dhe Finiq (100%), në Konispol, 70%, Vlorë, 60%. Shërbimet jo publike ofrohen vetëm në Vlorë, 25%, ndërsa shërbimet e përziera dominojnë plotësisht në Selenicë, në Konispol 30% dhe në Vlorë, 35%. Bashkitë Himarë dhe Delvinë nuk ofrojnë asnjë shërbim.


Figura 59: Shërbimet sipas llojit dhe financimit



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 60 ilustron jo vetëm numrin mesatar të përfituesve sipas tipologjisë së shërbimeve, por edhe peshën specifike të secilës tipologji shërbimi në secilën bashki. Bashkia Vlorë ofron 6 tipologji shërbimesh nga 8, në të cilat dominojnë shërbimet parashoqërore, komunitare dhe residenciale. Bashkitë e Sarandës dhe Konsipolit ofrojnë 3 tipologji shërbimesh. Bashkia Sarandë ofron shërbime residenciale, komunitare dhe emergjence, ndërsa bashkia Konispol ofron shërbime emergjence, në familje dhe të kujdesit alternativ. Bashkia Finiq ofron 2 tipologji shërbimesh përkatësisht emergjence dhe në familje.


Figura 60: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas tipologjisë



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 61 ilustron numrin mesatar të përfituesve për çdo shërbim sipas grupit të përfituesve si edhe sipas bashkive. Siç konstatohet, në Bashkinë Vlorë përfitojnë shërbime 2 grupe, përkatësisht “Fëmijë jashtë kujdesit prindëror” dhe “Viktima të dhunës në familje”, përkatësisht 56 dhe 151 përfitues mesatarisht për shërbim. Në bashkinë Sarandë përfitojnë shërbime 4 grupe, përkatësisht “Familje në nevojë”, “Fëmijë jashtë kujdesit prindëror”, “Fëmijë me AK” dhe “Të moshuar”, përkatësisht 10,30,31 dhe 45 përfitues/shërbim. Në Konsipol gjithashtu përfitojnë shërbime 4 grupe : “Familje në nevojë”, “Fëmijë jashtë kujdesit prindëror”, “Fëmijë me AK” dhe “Të moshuar”, përkatësisht 146,1,12 dhe 336 përfitues/shërbim. Në bashkinë Finiq përfitojnë shërbime vetëm grupi i të “Rriturve me AK”, shërbime tejet të kufizuara në numër.


Figura 61: Numri mesatar i përfituesve për një shërbim sipas grupeve



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

Figura 62 ilustron mënyrën e ndarjes të përfitimeve sociale, ndërmjet pagesave monetare për individë të familjeve të varfëra (NE), pagesën e aftësisë së kufizuar si edhe përfituesit e shërbimeve. Qartësisht vërehet se përfituesit e shërbimeve zënë peshë specifike mjaft të vogël në totalin e përfituesve të përkrahjes dhe mbrojtjes sociale.

Figura 62: Përfituesit e ndihmës monetare dhe shërbimeve, në %, sipas bashkive dhe qarkut



Burimi: Të dhëna administrative, Zyrat e shërbimeve sociale në bashki, 2021

8

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Në përfundim të përpunimit të të dhënave dhe analizës së thelluar të informacionit të mbledhur, identifikohen disa çështje kritike, që duhet të jenë në vëmendje të institucioneve qendrore, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit, e më tej, për të arritur tek integrimi dhe përfshirja sociale e individëve në nevojë, të përjashtuar ose në rrezik përjashtimi:

1. Ndërtimi i metodologjisë së unifikuar të raportimit të të dhënave në nivel qendror dhe lokal. Të dhënat duhet të evidentojnë institucionet, shërbimet dhe përfituesit, si dhe të mblidhen dhe raportohen në mënyrë të periodike.
2. Kuptimi i njëjtë mbi "shërbimet sipas llojit, tipologjisë dhe grupeve përfituese" për të shmangur plotësisht mundësinë e keqinterpretimeve gjatë raportimeve.
3. Rritja e kapaciteteve institucionale të ofruesve të shërbimeve, përfshirë të punonjësve të shërbimeve sociale në çdo bashki të vendit, veçanërisht në drejtim të monitorimit dhe raportimit mbi shërbimet sociale.
4. Ndërtimi dhe përmirësimi i standardeve të shërbimeve me tregues të qartë për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1

Qarku

Bashkia

PYETËSOR/Tabelë: Informacion mbi shërbimet sociale.

Shënim: Ky informacion mblidhet në kuadrin e Hartëzimit të Shërbimeve Sociale⁵. Të dhënat në tabelën më poshtë duhet të pasqyrojnë situatën sot, Maj 2021. Për të saktësuar kuptimin e llojit të shërbimit apo të institucionit që e ofron, referojuni Ligjit 121/2016 dhe VKM 518, datë 4/9/2018. Lexoni me vëmendje “Udhëzim për plotësimin e informacionit”, që ju dërgohet së bashku me këtë pyetsor/tabelë)si edhe referojuni “Tabelës MODEL” për saktësim.

KOLONA 1	KOLONA 2	KOLONA 3	KOLONA 4	KOLONA 5	KOLONA 6	KOLONA 7
<p>Emri i plotë i institucionit që ofron Shërbime Sociale si edhe adresa e saktë, e shoqëruar me numër kontakti.</p> <p>Nëse institucioni ofron disa lloje shërbimesh, secili prej tyre do të pasqyrohet në një rresht të veçantë.</p>	<p>Lloji i shërbimit që ofron</p> <p>A. Shërbime parashoqërore</p> <p>B. Shërbime rezidenciale, përfshirë strehëzat</p> <p>C. Shërbime komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit.</p> <p>D. Shërbime në familje.</p> <p>E. Shërbime të specializuara.</p> <p>F. Shërbime këshillimi on-line ose me telefon.</p> <p>G. Shërbime në situatë emergjence.</p> <p>H. Shërbime të kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror.</p>	<p>Tipi i institucionit që ofron shërbimin</p> <p>A. Publik</p> <p>B. Jo-publik</p> <p>C. I përzier</p>	<p>Financimi i institucionit që ofron shërbimin</p> <p>A. Qeveria qendrore</p> <p>B. Qarku</p> <p>C. Bashkia</p> <p>D. Organizatë ndërkombëtare</p> <p>E. OJF lokale</p> <p>F. Fondacion</p> <p>G. E përzierë (specifikoni)</p>	<p>Përfituesit e shërbimeve</p> <p>A. Familje në nevojë(të varfër, probleme sociale, etj)</p> <p>B. Fëmijët jashtë kujdesit prindëror</p> <p>C. Fëmijë me aftësi të kufizuara(sipas llojit të aftësisë së kufizuar, përkatësisht: terapi zhvillimi, psiko-sociale, të foluri, fizike dhe okupacionale/punë).</p> <p>D. Të rinj nga familje të përjashtuara</p> <p>E. Të rinj në konflikt me ligjin</p> <p>F. Të rritur me aftësi të kufizuara (sipas llojit të aftësisë së kufizuar, përkatësisht: terapi zhvillimi, psiko-sociale, të foluri, fizike dhe okupacionale/punë)</p> <p>G. Të pastrehë</p> <p>H. Viktima të dhunës në familje</p> <p>I. Viktima të trafikimit</p> <p>J. Minoritete etnike (Romë & Egjiptianë)</p> <p>K. Të moshuar</p> <p>L. Të tjerë(specifiko)</p>	<p>Numri total i përfituesve dhe sipas gjinisë:</p> <p>Total</p> <p>Femra</p> <p>Meshkuj</p> <p>Shënim: Nëse ofroni shërbime për më shumë se sa një grup përfituesish, atëhere shëno numrin e përfituesve për secilin grup, siç ilustrohet tek Tabela Model.</p>	<p>Numri total i stafit që ofron shërbime, sipas llojit të shërbimit</p>

⁵ Sipas legjisllacionit shqiptar (ligji 121/2016), sistemi i shërbimeve sociale përfshin shërbimet e mëposhtme: shërbime parashoqërore, shërbime rezidenciale ku përfshihen edhe strehëzat, shërbime komunitare, shërbime në familje,

1. Qendra YYYYYY Njësia Bashkiake Rruga: Nr.: Kontakt: Tel:	B	A	A	C	52	12
	D			C	12	2
2. Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Rastit, Bashkia....	A	A	C	A	15	2
				B	2	2
				G	7	2
				H	9	1

Terapi zhvillimi,
Psiko-sociale.
Fizike.

Femra:15
Meshkuj:37
12 (F:3, M:9)
20 (F:7, M:13)
20 (F:5, M:15)

Të foluri
Okupacionale

Femra: 11
Meshkuj:1
11 (F:1, M:10)
1 (M:1)

Femra: 15
Meshkuj: 2
Femra: 6
Meshkuj:1
Femra: 5
Meshkuj:4

SHTOJCA 2

Udhëzues për plotësimin e informacionit (shih modelin në tabelën e pyetësorit)

Me qëllim mbledhjen e saktë dhe në mënyrë të unifikuar të të dhënave, ju lutem konsideroni:

1. Shërbimet shoqërore klasifikohen sipas VKM Nr. 518, date 4/9/2018. Në veçanti, sipas kësaj VKM, Shërbimet parashoqërore përfshijnë shërbime informimi dhe këshillimi, ndërhyrja e hershme, këshillimi on-line. Shërbimet parashoqërore konsiderohen si shërbime komunitare dhe ofrohen nga strukturat e posaçme të shërbimeve shoqërore në kuptim të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror, për rrjedhojë, gjatë raportimit për shërbime parashoqërore, konsideroni vetëm ato shërbime të cilat janë dokumentuar.
2. Për lehtësi veprimi, shërbimet janë shënuar me germa. Ju do të shënoni vetëm germen që i korespondon shërbimit që ofrohet në bashkinë tuaj.
3. Në kolonën e parë, në rreshta të veçanta, shënohet emërtimi i të gjitha institucioneve që ofrojnë shërbime sociale, së bashku me adresën e plotë si edhe adresën e një personi kontakti, siç paraqitet në tabelë.
4. Në kolonën e dytë, paraqiten të gjitha llojet e shërbimeve që çdo qendër ofron. Nëse një qendër ofron më shumë se një shërbim, atëherë secili shërbim do të paraqitet në një rresht të veçantë, siç tregohet në shembullin në tabelë (shih Qendra YYYY, e cila ofron Shërbimin A dhe shërbimin B).
5. Në kolonën e tretë paraqitet "tipi i institucionit". Mqs, pavarësisht numrit të shërbimeve, tipi i institucionit është vetëm një, këtu shënohet njera nga 3 gerrat: A,B ose C.
6. Në kolonën e katërt shënohet mënyra e financimit të institucionit. Edhe këtu, mqs mënyra e financimit është vetëm 1, do të shënohet vetëm një nga gerrat: A,B,C,D,E,F,G. Kujdes: Nëse mënyra e financimit është e prëzrierë, atëherë do të shënohet germa "G" dhe do të sqarohet se çfarë lloj financimi është, psh: nga Qeveria qendrore dhe qarku (A dhe B), Nga Qeveria qendrore dhe Bashkia (A dhe C), Nga Bashkia dhe Organizatë Ndërkombëtare (C dhe D), etj.
7. Në kolonën e pestë shënohen grupet që përfitojnë shërbimet. Mqs një qendër mund të ofrojë shërbime për më shumë se sa një grup, edhe këtu secili grup do të shënohet në rresht të veçantë, por tashmë duke respektuar kategorizimin e shërbimeve për secilën qendër. Kujdes plotësimin e specifikimeve për kategorinë e shërbimeve të aftësisë së kufizuar, përkatësisht KOLONA 5, kategoria "C" dhe "F". Për këto dy grupe, do të specifikohet edhe lloji i aftësisë së kufizuar, siç sqarohet tek modeli në tabelën e pyetësorit.
8. Në kolonën e gjashtë shënohet numri i përfituesve për secilin shërbim. Numër përfituesish do të konsiderohet numri më i madh i përfituesve që rezultojnë të regjistruar në vitin e fundit që përfshin periudhën Qershor 2020-Maj 2021. Kështu për shembull, nëse në një qendër janë regjistruar dhe kanë marrë shërbime në Qershor, Korrik, Tetor, Dhjetor 2020 përkatësisht 25 persona në muaj, në Gusht, Shtator, Nëntor 2020 përkatësisht 28 persona në muaj, Janar 2021 30 persona në muaj, ndërsa nga Shkurti deri në Maj 2021 përkatësisht 15 persona çdo muaj, ju do të deklaroni tek numri i përfituesve: 30 persona, që i korespondon numrit më të madh të përfituesve, të regjistruar në Janar 2021. Nuk është e nevojshme të shënoni periudhën referencë. E rëndësishme është që **numri i përfituesve të korespondojë me numrin më të madh të personave të regjistruar dhe që kanë marrë shërbime në një muaj, në periudhën referuese, Qershor 2020-Maj 2021. Numri i përfituesve, pavarësisht llojit të shërbimit, do të kategorizohet edhe sipas gjinisë, femra dhe meshkuj. Kujdes gjithashtu saktësinë e numrave. Shuma e përgjithshme e përfituesve dhe sipas gjinisë duhet të korespondojë me numrin e përfituesve sipas çdo kategorie shërbimi dhe sipas gjinive përkatëse.**

Le ta konkretizojmë me shembullin në vijim:

Qendra YYYY ofron "Shërbime rezidenciale" dhe "Shërbime në familje", pra në kolonën 2 do të shënohen "B" dhe "D". Meqenëse qendra është "Publike", në kolonën 3 shënohet "A". Meqenëse qendra financohet nga "Qeveria qendrore", në kolonën 4 shënohet "A". Meqenëse qendra i ofron të dy llojet e shërbimeve për "Fëmijë me aftësi të kufizuara", numri i të cilëve është i ndryshëm në secilin shërbim, atëherë në rreshtin që i takon shërbimit "B", tek kolona 5 shënojmë "C" dhe tek kolona 6, shënojmë 52, ndërsa në rreshtin që i takon shërbimit "D", tek kolona 5 shënojmë "C" dhe tek kolona 6 shënojmë 12.

Numri i përfituesve do të kategorizohet dhe sipas gjinisë, siç tregohet në tabelë, kolona 6.

Tek kolona 5, do të specifikohet lloji i aftësisë së kufizuar, ndërsa tek KOLONA 6, do të shënohet edhe numri i përfituesve sipas specifikimit të aftësisë së kufizuar, e ndarë edhe sipas gjinisë.

Nëse secili nga shërbimet "B" dhe "D" do të sigurohet për kategori të ndryshme përfituesish, atëherë tek rreshti përkatës do të shënohet kategoria përkatëse e përfituesve si edhe numri përkatës, e kategorizuar edhe sipas gjinisë.

Në përgjithësi, shërbime për kategori të ndryshme përfituesish mund të sigurohen në rastin e "Shërbimeve parashoqërore" (A), "Shërbimeve komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit" (C), "Shërbimeve në familje (D), "Shërbimeve të këshillimit on-line ose me telefon" (F) ose "Shërbimeve në situatë emergjence" (G). Pavarësisht nga lloji, specifikimi i grupeve përfituese dhe numri përkatës duhet të bëhet sipas sqarimit të mësipërm.

9. Në kolonën e shtatë, shënohet "Numri total i stafit që ofron shërbime, sipas llojit të shërbimit". Këtu do të përfshihet l gjithë personeli që mundëson realizimin e shërbimit.
10. Duhet të shënohen të gjitha shërbimet që përkujnë me përkufizimin e ligjit dhe VKM 518, pavarësisht nga përmasat, rëndësia, ofruesi apo numri i përfituesve. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet përshkrimet të "Shërbimeve parashoqërore" të cilat zakonisht dhe kryesisht ofrohen nga strukturat e bashkisë (Njësitë vlerësimit dhe referimit të rastit) apo (Drejtoria/ sektori i shërbimeve shoqërore). Në këtë rast, tek Kolona 1 do të jepet emërtimi i plotë i Njësisë që e ofron shërbimin. Kolonat e tjera plotësohen në përputhje me sqarimet e dhëna tek pika 8. Kujdes tek plotësimi i kolonës 5 dhe 6, mqs zakonisht shërbimet parashoqërore jepen për grupe të ndryshme përfituesish. Duhet të specifikohen të gjitha grupet, si tek shembulli i dhënë në tabelën referencë.

SHTOJCË 3

Numri e institucioneve, shërbimeve dhe përfituesve sipas bashkive dhe qarqeve

Treguesit	Institucione publike						Institucione jo publike						Gjithsej		
Bashkitë	Të moshuar	Fëmijë	PAK	Gra	Multi-disiplinare	Gjithsej	Të moshuar	Fëmijë	PAK	Gra	Multi-disiplinare	Gjithsej	Institucione	Shërbime	Përfitues
1.Tiranë	1	2	1	3	6	13	14	12	19	10	6	61	74	84	9,983
2.Kavajë	1		1			2						0	2	5	407
3.Rrogozhinë						0						0	0	0	0
4.Kamëz	1					1		3			1	4	5	7	4,190
5.Vorë	1					1		2				2	3	18	213
1.Qarku Tiranë	4	2	2	3	6	17	14	17	19	10	7	67	84	114	14,793
6.Durrës	1	5	2	1	1	10		1	4	4	1	10	20	24	975
7.Shijak			1			1						0	1	7	48
8.Krujë	1				1	2		1	1			2	4	14	269
2.Qarku Durrës	2	5	3	1	2	13		2	5	4	1	12	25	45	1,292
9.Gjirokastrë	1		1			2		1		1	1	3	5	18	520
10.Libohovë						0						0	0	0	0
11.Dropull					1	1					1	1	2	2	65
12.Tepelenë						0			0			0	0	0	0
13.Memaliaj						0			1			1	1	1	0
14.Përmet			1			1						0	1	6	125
15.Këlcyrë		3				3		2				2	5	11	428
3.Qarku Gjirokastrë	1	3	2		1	7		3	1	1	2	7	14	38	1,138
16.Lezhe	1				1	2		6		1	1	8	10	20	578
17.Kurbin						0		1				1	1	6	1,187
18.Mirdite						0		2				2	2	2	3
4.Qarku Lezhë	1				1	2		9		1	1	11	13	28	1,768

19.Berat	1	3	2		2	8				1	2	3	11	12	255
20. Kuçovë		1			1	2						0	2	5	431
21.Poliçan	2					2						0	2	3	109
22.Skrapar		1				1						0	1	2	32
23.Ura Vajguore					1	1						0	1	1	43
5.Qarku Berat	3	5	2		4	14				1	2	3	17	22	827
24.Diber			1			1	1		1	2	1	5	6	6	63
25.Mat						0		2				2	2	5	3542
26.Bulqize		1				1						0	1	2	25
27.Klos					3	3		2				2	5	5	1514
6.Qarku Dibër		1	1		3	5	1	4	1	2	1	9	14	18	5,144
28.Elbasan	1	2	2			5	3	8	8	10	6	35	40	50	1284
29.Gramsh				1	1	2						0	2	2	17
30.Librazhd						0	1					1	1	6	258
31.Peqin						0		1				1	1	2	24
32.Cerrik						0		2				2	2	2	93
33.Belsh					2	2		1				1	3	3	82
34.Prrenjas			1	1	1	3				1		1	4	7	137
7.Qarku Elbasan	1	2	3	2	4	12	4	12	8	11	6	41	53	72	1,895
35.Kukës	1		1	1		3		1	1	1	1	4	7	8	861
36.Tropojë				1	1	2						0	2	2	16
37.Has				1	1	2						0	2	2	3
8.Qarku Kukës	1		1	3	2	7		1	1	1	1	4	11	12	880
38. Korçë	1	2	2			5		1	3	1		5	10	13	590
39.Devoll					1	1				1		1	2	4	64
40.Kolonjë						0	1	1				2	2	6	89

41.Pogradec			1			1	1		3			4	5	9	864
42.Maliq						0		1		1		2	2	4	90
43.Pustec (Liqenas)		1				1	1				1	2	3	3	23
9. Qarku Korçë	1	3	3		1	8	3	3	6	3	1	16	24	39	1,720
44.Vlorë		1	3	4	2	10		4	4	3		11	21	27	207
45.Selenicë						0				1		1	1	1	0
46.Himarë						0						0	0	0	0
47.Sarandë	1	1	1	1		4			1			1	5	5	116
48.Konispol				1	1	2		1				1	3	3	495
49.Finiq				1	1	2						0	2	2	10
50.Delvinë						0						0	0	0	0
10. Qarku Vlorë	1	2	4	7	4	18		5	5	4		14	32	38	828
51.Fier	1		1		3	5					2	2	7	10	443
52.Patos			1		1	2						0	2	2	223
53.Roskovec	1			1		2					2	2	4	4	37
54.Lushnje			1			1				1		1	2	3	64
55.Divjakë						0				1		1	1	2	65
56.Mallakastër						0			1			1	1	2	44
11.Qarku Fier	2		3	1	4	10			1	2	4	7	17	23	876
57.Shkodër	1	4	1		1	7	2	4	7	7		20	27	31	10319
58.Malësi e madhe			1			1					2	2	3	5	953
59.Vau I Dejës	1					1				2		2	3	5	66
60.Pukë						0				1		1	1	1	4
61.Fushë Arrëz						0				1		1	1	1	7
12. Qarku Shkodër	2	4	2		1	9	2	4	7	11	2	26	35	43	11,349
Gjithsej Shqipëria	19	27	26	17	33	122	24	60	54	51	28	217	339	493	42,553

